




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 572

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Gjurmoc

E enjte, më 15 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 16:20 –17:05

Vendi i takimit: SHMFU "Lasgush Poradeci"

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani, Drejtorja e Drejtorisë së Arsimit, Yllka Fejzullahu, Drejtori për Administratë të Përgjithshme, Valon Januzi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Z. Adnan Ademi- Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjim publik. Qëllimi i këtij takimi është hartimi i buxhetit për vitet 2024-2026 dhe me ju do të bisedojmë për nevojat dhe kërkesat që keni secili prej jush në lagjet prej nga vini.

Pas kësaj, Kryesuesi e shpalli të hapur debatin: Këtu jam së bashku me drejtorin Grejtalb Emini, Drejtorin Valon Januzi, Drejtorin Kastriot Shabani dhe me Drejtoren Yllka Fejzullahu. Presim nga ju kërkesa e propozime.

Z. Grejtalb Emini- Ne Gjurmoc janë bërë disa investime gjatë vitit 2023, projekte të cilat do të vazhdojnë edhe përgjatë këtyre viteve.

Ne kemi planifikuar që përgjatë këtij viti të fillojmë disa projekte për asfaltimin e rrugicave në disa lagje, ndriqimin dhe trotuarin. Ndoshta nevojat janë edhe më të mëdha por është përcaktuar një mesatare për çdo vendbanim.

Z. Emini e elaboroi ne tërësi për të gjitha projektet urbane duke cekur edhe shumën e ndarë për secilën prej tyre.

Z. Nazif Sadriu - banore e këtij fshati theksoi se ka shumë nevojë për investim pasi deri më tani ky fshat ishte i lënë pas dore nga qeverisja e kaluar.

Kërkesat kryesore ishin:

Rregullimi i rrugës kryesore i cila i lidh disa lagje, gjithashtu rregullimi i rrugës kryesore në Shtime.

Zgjerimi i rrugës dhe rregullimi i trotuarit në rrugën Besim Sopa (por ky rregullim i trotuarit të mos bëhet me kubëza por me asfalt pasi është më i qëndrueshëm).

Rregullimi i rrethojave të shkollës, pasi mosrregullimi i tyre sjell rrezik për nxënësit.

Rregullimi i ndriqimit në rrugën Kastrati.

Rregullimi i kanalizimit në lagjen Hoxhaj.

Z. Grejtalb Emini - Ju lutem përcaktoheni në kërkesa konkrete. Ne do t'i shqyrtojmë secilën nga kërkesat e juaja, por siç thoni ju të bëhet trotuar nga asfalti e jo kubëzat, sepse është e pamundur për shkak të infrastrukturës së papërfunduar pasi ne nuk e kemi atë standard.

Z. Emini e elaboroi në tërësi për të gjitha projektet urbane duke cekur edhe shumën e ndarë për secilën prej tyre.

Z. Hysen Hoxha - banor i këtij fshati tregoi që në lagjen prej nga vjen ka shumë nevojë për investime.

Kërkesat e tij ishin:

1. Rruga nga Hoxhë Sinani e deri në Godanc është e shtruar me zhavor, por një pjesë e saj e cila e përfshin lagjen tonë nuk është shtruar andaj kerkoi rregullimin e saj pasi po ndihemi të diskriminuar.
2. Rregullimi i ndriqimit dhe rregullimi i trotuarit në lagjen Hoxhë Sinani.
3. Asfaltimi i rrugës nga shtëpia e Beqir Hoxhës deri tek varrezat.

Z. Emini e elaboroi në tërësi për të gjitha projektet urbane duke cekur edhe shumën e ndarë për secilën prej tyre.

Z. Xhafer Ahmei – banor i këtij fshati kishte këto kërkesa:

1. Tensioni i ulët i rrymës i cili dëmton pajisjet elektrike në mbarë fshatin.
2. Rregullimi i hapësirave të varrezave.
3. Rruga e varrezave që del te pjesa e Hoxhë Sinanit të kthehet në gjendjen e mëparshme.
4. Rregullimi i parkingut para shkollës (me kubëzat e mbetura nga shtrimi i trotuareve).

Z. Emini e elaboroi në tërësi për të gjitha projektet urbane duke cekur edhe shumën e ndarë për secilën prej tyre si dhe kohën se kur priten të perfundojnë këto projekte.

Procesmbajtës
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi: Gjyrkovc

Date: 15.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Arind Rama	
2	Ermond Gashi	
3	Gëzim Aliu	
4	Nasir SADRRI	
5	HUSEN HOKHA	
6	FAZLI SYLA	
7	XHAFER RHMU	
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		